AVOKATI I POPULLIT

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT
Seksioni i Përgjithshëm

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax:+355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. K1/ I 94-5 Prot. **Tiranë 15/12//2022**
Nr. Dok. 202201266/5

Lënda: Sugjerim për vlerësimin e mundësive që familja P. të përfitojë nga programet sociale të strehimit në Bashkinë Lushnjë, për përmirësimin e kushteve të banesës ekzistuese.

Drejtuar: ***Bashkia Lushnje,***

LUSHNJE

Të nderuar,

Institucioni i Avokatit të Popullit, në përputhje me paragrafin e parë të nenit 13 të Ligjit nr.8454, datë 04.02.1999 "Për Avokatin e Popullit" i ndryshuar, në respektim të detyrimeve ligjore që rrjedhin në zbatim të Kushtetutës dhe të ligjit, për garantimin e të drejtave, lirive themelore dhe interesave të shtetasve shqiptarë dhe atyre të huaj, ka regjistruar rastin e denoncuar në median "Top Channel" në emisionin " Fiks Fare" lidhur me problematikën e familjes P. dhe po shqyrton këtë çështje.

Kronika tregon qartazi kushtet shumë të vështira sociale/ekonomike në të cilat jeton familja P. dhe ndihma nga institucionet përgjegjëse konsiderohet e rëndësishme sidomos në të mirë të shëndetit të personave në nevojë në përberje të kësaj familjeje.

Në vijim të procedurës, institucioni i Avokatit të Popullit i është drejtuar Bashkisë Lushnjë dhe Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Social Fier me "Kërkesën për shpjegime" shkresa nr. K1/I94-2, datë 07.11.2022.

Me shkresën nr 9928/1, datë 14.11.2022, Drejtoria e Shërbimit Social, Bashkia Lushnjë, në përgjigje të shkresës së Avokatit të Popullit nr. K1/I94-2, datë 07.11.2022, na informon për situatën ekonomike të familjes Prifti dhe të mbështetjes sociale që përfitojnë anëtarët

e saj, bazuar në ligjin nr.57/2019 “Për Asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë”, për masat e marra për normalizimin e kushteve të jetesës së kësaj familjeje si dhe për informacionin për të ndryshuar kujdestaren.

Gjithashtu, me shkresën nr258/1, datë 16.11.2022, Drejtoria Rajonale e Shërbimit Social Shtetëror Fier na informon se pas referimit të rastit nga emisioni “Fiks Fare” për gjendjen e mjerueshme në të cilën ishin lënë anëtarët e kësaj familjeje nga kujdestarja e tyre, inspektorja e Ndihmës Ekonomike dhe Përkrahjes Sociale së bashku me administratorin e Njësisë Administrative, pas vizitës së kryer në banesën e familjes P., kanë konstatuar së gjendja e jetesës së tyre ishte e mjerueshme. Gjithashtu u është bërë e ditur dhe e drejta e tyre për të ndryshuar kujdestaren nëse ajo nuk u përgjigjet nevojave të tyre, duke zgjedhur nje kujdestar tjetër dhe për këtë nëse do vendosin të veprojnë,5 do ndihmohen në aspektin orientues nga administratori shoqëror. Familja P. do jetë në mbikqyrje të administratorit shoqëror social, në mënyrë që shërbimet për të cilat kjo familje ka nevojë të kryhen me përgjegjësi nga kujdestarja.

Në lidhje me sa më sipër Avokati i Popullit vlerëson se ka nevojë për përmirësim të sistemit të verifikimit të kushteve në të cilat jetojnë përsonat që kanë nevojë për përkujdesje, përderisa shteti ka detyrim t’u sigurojë atyre një jetë dinjitoze.

Ne vlerësojmë proaktivitetin e punonjësve të Bashkisë pas denoncimit të rastit emisionin “Fiks Fare”, por nuk justifikojmë dot faktin që për të marrë masa kjo çështje duhej të bëhej objekti i një emisioni televiziv, duke krijuar shqetësim të mëtejshëm për personat në nevojë për përkujdesje.

Avokati i Popullit është koshient se jetesa në familje dhe përkujdesja e familjarëve është mënyra më e mirë e përkujdesjes së kështillueshme për kata persona, por ka vend për të ushtruar një kontroll më efektiv që këta qytetatë në nevojë të mos jenë në kushte të tilla.

Bashkia duhet të krijojë një system më efektiv verifikimi të kushteve të jetesës dhe nevojave që mund të ketë kjo kategori për të shmangur ndodhjen e ngjarjeve të tilla në të ardhmen.

Duke vlerësuar masat e marra për monitorimin e shërbimeve të ofruara në dobi të anëtarëve të familjes Prifti, nga institucionet përgjegjëse, por dhe përgjigjet e shpejta dhe bashkëpunimin e tyre me institucionin e Avokatit të Popullit, mbetet pa konsideruar nga ana e tyre fakti i kushteve të papërshtatshme të banesës ku jeton kjo familje.

Sa tregohet në kronikën e emisionit “Fiks Fare” por dhe nga informacioni i dërguar shkresërisht institucionit të Avokatit të Popullit nga Drejtoria e Shërbimit Social, Bashkia Lushnjë ku pranohet fakti që kjo familje banon në kushte të mjerueshme, vërehet qartazi që kjo familje ka nevojë për mbështetje të mëtejshme nga institucioni i Bashkisë Lushnjë nëpërmjet programeve sociale të strehimit, konkretisht sa parashikon ligji Ligji Nr. 22/2018 “Për Strehimin Social” për përmirësimin e kushteve të banesave ekzistuese, me qëllim që banesa të shndërrohet në një strehim të përshtatshëm, sipas kushteve të parashikuara në nenin 4 të këtij ligji.

Si rrjedhojë, duke bashkëpunuar, bashkërenduar dhe koordinuar punën, me qëllim zgjidhjen e problematikave të hasura gjatë shqyrtimit të këtij rasti, në përputhje me legjislacionin në fuqi, **të përpiqemi për të gjetur rrugët dhe mjetet e domosdoshme për ofrimin e ndihmës konkrete kësaj familjeje për të kapërcyer sa më denjësisht këtë situatë**, **duke kryer një vlerësim objektiv dhe të menjëhershëm të gjithë situatës që ajo ndodhet, duke garantuar në mënyrë të plotë shërbimet bazë sociale.**

Për sa më sipër, Avokati i Popullit në vijim të plotësimit të misionit ligjor në rolin e nxitësit të standardeve më të larta të të drejtave dhe lirive të njeriut në vend, bazuar në nenin 63/3 të Kushtetutës ku parashikohet se: "*Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga administrata publike*"; si dhe nenin 21/b të ligjit nr. 8454 datë 04.02.1999 "Për Avokatin e Popullit", i ndryshuar, ku parashikohet se: "*Avokati i Popullit paraqet rekomandime për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ, që, sipas tij ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive*",

<u>Sugjeron:</u>

Marrjen e masave për vlerësimin e mundësive që familja P. të përfitojë nga programet sociale të strehimit në Bashkinë Lushnjë, me fokus përmirësimin e kushteve të banesës ekzistuese me ndërhyrje dhe përmirësime të domosdoshme, në interes të shëndetit të të sëmurëve në përbërjë të kesaj familjeje.

Për qëndrimin që do të mbani dhe masat që do të merrni, të vihemi në dijeni brenda afatit 30 ditor, parashikuar nga neni 22 i ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999 "Për Avokatin e Popullit", i ndryshuar.
Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj.

KOMISIONERE

VILMA SHURDHA

DV